



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Kriza politike në Kosovë/ Kurti e Abdixhiku sërish në bisedime, kreu i LDK: Përpjekje do të ketë, por numrat për Presidentin mungojnë
- 2

Qeveria bllokoi në Thesar pagat e magistratrëve, kreu i Gjykatës së Lartë letër Ministrit të Financave: Zhblokoni menjëherë pagesat mujore të gjyqtarëve
- 3

Ilir Demalia: Rama, Rama të ...
- 4

Bollino refuzon prapë pajtimin në GJKKO, dhëndri i Berishës sulmohet nga një qytetarë: Me atë beretë je hajdut tokash (VIDEO)
- 5

Protesta/ Petraj: S'të çon askund, s'ka një 'kokë' në krye! Muçi: Dje u përballa me sharje e shtyrje nga njerëz pa uniformë policie brenda Komisarariatit!

Kronikë

Po udhëtonte drejt Anglisë me gruan dhe 4 fëmijët e mitur, kapet në Rinas me pistoletë në bagazh, arrestohet 42-vjeçari: Harrova që e kisha në çantë! (EMRI)

Sokol Krasniqi u ndal pasi skaner i zbuloi armën me municion në çantën e tij. Ai pretendoi se e kishte harruar pas disa ditësh në Tropojë, ku kishte bërë qitje me shokët.



Arma e sekuestruar

Redaksia

2 Shtator, 14:22 | Përditësimi: 2 Shtator, 14:34

Share

Post

WhatsApp



Një 42-vjeçar është arrestuar në Aeroportin e Rinasit, pasi në bagazhin e tij u gjet një [armë zjarri](#) pistoletë me municion luftarak, teksa po udhëtonte drejt Mbretërisë së Bashkuar së bashku me bashkëshorten dhe katër fëmijët e tyre të mitur.

Në pranga ra [Sokol Krasniqi](#), shtetas shqiptar me nënshtetësi britanike. Sipas Policisë Kufitare, arma u zbulua gjatë kontrollit me skaner në dalje nga Shqipëria. Pistoleta kishte një fishek në fole, ndërsa në karikator u gjetën edhe gjashtë fisheke.

Krasniqi është me origjinë nga Kosova por familja e tij ishte shpërngulur në Kukës që prej viteve '90, ndërsa familja e tij ishte shpërngulur në Kukës që prej viteve '90. Prej disa vitesh ai jetonte në Mbretërinë e Bashkuar.



LEXO EDHE:

Protesta/ Petraj: S'të çon askund, s'ka një 'kokë' në krye! Muçi: Dje u përballa me sharje e shtyrje nga njerëz pa uniformë policie brenda Komisarariatit!

Pas arrestimit, 42-vjeçari deklaroi se gjatë pushimeve kishte qëndruar në zonën e Tropojës, ku, sipas tij, kishte bërë qitje me disa shokë. Ai pretendoi se pistoletën dhe karikatorin i kishte harruar në çantë dhe nuk e kishte kuptuar se po udhëtonte me armën e zjarrit.

Njoftimi i plotë i Policisë

"Intensifikimi i kontrolleve nga Policia Kufitare godet një rast të tentativës për të trafikuar armë zjarri nga Shqipëria në Mbretërinë e Bashkuar. Sekuestrohet 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak.

Arrestohet në flagrancë poseduesi i saj. Si rezultat i kontrolleve të dedikuara, bazuar në analizën e riskut dhe në informacionet e inteligjencës policore, të intensifikuara për shkak të fluksit në hyrje/dalje, shërbimet e Policisë Kufitare të PKK [Rinas](#), në bashkëpunim me shërbimet e sigurisë në aeroportin e Rinasit, goditën një rast të tentativës për të trafikuar armë zjarri nga Shqipëria në Mbretërinë e Bashkuar. Për këtë rast, u arrestua në flagrancë shtetasi shqiptar (me nënshtetësi britanike) S. K., 42 vjeç, banues në Angli.

Nga kontrolli nëpërmjet skanerit, në bagazhet e këtij shtetasi, në dalje të Shqipërisë, u gjet 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm [Tiranë](#), për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Trafikimi i armëve dhe i municionit".

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

U.D/Shqiptarja.com

TAG: [Tirane](#) [arme zjarri](#) [rinas](#) [sokol krasniqi](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



1.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohejt rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

Bashkia e Tiranës pa drejtues në zyrë, kush e ka përgjegjësinë?

30 Gusht, 11:16

[Politika](#) [Drejtësia](#) [Nuk e di](#)

Lajme të tjera



Partia e Lirisë: Transporti publik po goditet nga kostoja e karburantit, qeveria të ulë barrën fiskale mbi naftën

2 Shtator, 13:58



Lëvizjet në Bashkinë e Tiranës, Veliaj shkakton edhe nënkryetarin Blendi Sulaj

2 Shtator, 13:42



Me pistoletë në makinë tre të arrestuar në Fier! Tentuan të largoheshin pasi panë policinë (VIDEO)

2 Shtator, 12:50




Rama mbledh ministrat dhe drejtuesit politikë të qarqeve! Nesër takimi me Grupin e PS, 24 orët vendimtare për qeverinë

2 Shtator, 10:24




Përplasjet gjatë protestës ndërsa Rama ishte në zyrë, 14 të arrestuar! Policia: Bllokuan hyrje-daljet e Kryeministrit (EMRAT)

2 Shtator, 08:46




Rikthimi i Festivalit Kombëtar të Filmit Shqiptar, Rama: Do festojë artin, historinë dhe të ardhmen e kinematografisë sonë (VIDEO)

2 Shtator, 08:25




Protestuesit te Komisaritati nr.3, kërkojnë lirimin e të shoqëruarve! Përplasje edhe me efektivët, Policia 'gardh' para godinës (VIDEO)

1 Shtator, 22:58



Përplasja e protestuesve me Policinë, raportohet për një të lënduar! Shoqërohen në komisarariat rreth 15 persona, mes tyre edhe Dritan Goxhaj (VIDEO)

1 Shtator, 21:24



Eduard Zalosnjaja: Këllqet elektorale të protestës bulevardore mund të provohen në garën e Tiranës



[Eduard Zalosnjaja](#)

1 Shtator, 21:11



Protestuesit rrethojnë 2 orë hyrjen e Kryeministrit, përplasen me policinë! 15 të shoqëruar, tensione edhe te komisaritati nr.3! Rama lë zyrën pasi shpërndahen (VIDEO)

1 Shtator, 20:08



Braçe nga 'Komuna e Parisit': Rruga u pastrua nga inertet, por kjo ndotja vizive është e neveritshme (VIDEO)

1 Shtator, 12:46



Ç'përfaqësojnë mbi 1.7 milionë pasagjerë në Rinas në gusht?



[Fatos Çoçoli](#)

1 Shtator, 12:00

Lajmi i fundit



Kriza politike në Kosovë/ Kurti e Abdixhiku sërish në bisedime, kreu i LDK: Përpjekje do të ketë, por numrat për Presidentin mungojnë

2 Shtator, 19:11

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Pu





× **[Sh]**
.com Lajmi i fundit



Kriza politike në Kosovë/ Kurti e Abdixhiku sërish në bisedime, kreu i LDK: Përpjekje do të ketë, por numrat për Presidentin mungojnë

2 Shtator, 19:11

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

